

Udhëzime nga mjeku juaj

Mjeku/ja juaj ju ka këshilluar për kontrollin e ardhshëm një pastrim të zorrës me PLEINVUE®. Lexoni me kujdes fletë-udhëzuesin brenda në kuti, përpara se të filloni me përdorimin e këtij medikamenti dhe merreni gjithmonë me saktësi siç është përshkruar në fletë-udhëzues ose sipas udhëzimeve të mjekut ose të farmacistes suaj. Për informacione të tjera ju lutemi t'i drejtoheni mjekut tuaj ose në farmaci. Për informacione të mëtejshme të rëndësishme, duke përfshirë paralajmërimet e veçanta, efektet anësore dhe informacionin për ruajtjen e Pleinvue®, ju lutemi t'i drejtoheni fletushkës së paketimit.

Udhëzime për marrjen e vakteve të ngrënies gjatë ditës përpara kontrollit:

- një mëngjes i lehtë
- një drekë e lehtë *((duhet të jetë përfunduar të paktën 3 orë përpara marrjes së dozës së parë))*

Nga fillimi i përdorimit me Pleinvue® deri pas marrjes së masës klinike mos konsumoni ushqime të forta!

Mos pini alkool, mos pini qumësht, mos pini pije me ngjyrë të kuqe ose me ngjyrë vjollcë (p.sh. lëng të zi manaferre) ose pije të tjera që përmbajnë tul fryti.


MËNGJESI
rreth orës
6:00–10:00



DREKA
rreth orës
12:00–14:00



DARKA



Përgatitja

1 kuti Pleinvue® përmban në përgjithësi 3 qeska; Për dozën 1: 1 qeskë; Për dozën 2: 2 qeska (A+B)



DOZA 1



Hidhni përmbajtjen e dozës 1 në një enë që mund të mbajë të paktën 500 ml lëngje.



Mbusheni me 500 ml ujë. **Përzijeni derisa pluhuri të jetë tretur. Ky proces mund të zgjasë deri në 8 minuta.**

DOZA 2



Përgatitni përmbajtjen e dozës 2 (qeset A dhe B) në të njëjtën mënyrë në kohën e rekomanduar.

Sapo të përgatitet, Pleinvue® mund të pihet menjëherë ose të ruhet në frigorifer deri në 24 orë në temperaturë nën 25°C, e mbuluar.

Marrja e barit

Doza 1 në mbrëmjen përpara kontrollit

Doza 1
PLEINVUE®*



0,5 l

+

lëngje
pa ngjyrë**



min. 0,5 l



Pini Pleinvue® dhe lëngje të tejdukshme shtesë në GLLËNJKA të ndara në një periudhë prej të paktën 1 ore.*

Qëndroni gjatë kohës së marrjes në distancë të afërt të një tualeti.



KËRKOHEM INFORMACIONI MJEKËSOR

Data/Ora

*Për të shmangur dehidratimin, mund të pini lëng transparent përpara, gjatë dhe pas marrjes së Pleinvue®.

Është shumë e rëndësishme që të pini sasi të caktuara shtesë të lëngjeve pa ngjyrë.

**Ujë, supë pa ngjyrë, lëngje frutash pa tulin e frutit, pije freskuese, çaj dhe/ose kafë pa qumësht

Marrja e barit

Doza 2 në mbrëmjen përpara kontrollit (≥ 2 orë më vonë)

Doza 2 (A+B)
PLEINVUE®*



0,5 l

+

lëngje
pa ngjyrë**



min. 0,5 l



Pini Pleinvue® dhe lëngje të tejdukshme shtesë në GLLËNJKA të ndara në një periudhë prej të paktën 1 ore.*

Qëndroni gjatë kohës së marrjes në distancë të afërt të një tualeti.




KËRKOHEM INFORMACIONI MJEKËSOR

Data/Ora

KËSHILLË PRAKTIKE: Pijeni "Pleinvue" të ftohtë dhe/ose me pipëz. Pini çaj të nxehtë përpara "Pleinvue" që të "ngrohni" stomakun, në të kundërt mund të pini pak çaj të nxehtë midis intervaleve të pirjes së "Pleinvue". (Çajrat me bazë bimore, të tilla si çaji jeshil, çaji me bar blete, xhenxhefil apo limon.) Gjatë intervaleve, përdorni çamçakëz, thithni karamelle me mente ose feta limoni apo portokalli.

Kontrulli



Përfundoni marrjen e lëngjeve:

- dy orë përpara masave klinike me narkozë të plotë, ose
- një orë përpara masave klinike pa narkozë të plotë

KËRKOHEM INFORMACIONI MJEKËSOR

Data/Ora

Ju lutemi të planifikoni kohë të mjaftueshme pas marrjes së fundit, për kohën e udhëtimit për në kontrollin e enteroskopisë.

E RËNDËSISHME: Nuk ju lejohet të drejtoni automjetin pas një ekzaminimi me anestezi të përgjithshme. (Nuk ka mbulim nga sigurimi)